



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0568

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim-Paneliste Individuale duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) BAJRAM HA.GASHI B.I., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të KOMUNA SUHAREKË në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Rikonstruimi i kulmit të SH.M. Gjinnazi jeta e Re - Suharekë me numër të prokurimit 624-25-1994-5-2-1, me 15.09.2025, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “Bajram HA. Gashi B.I.” me nr. 2025/0568 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rikonstruimi i kulmit të SH.M. Gjinnazi jeta e Re - Suhareke” me numër të prokurimit 624-25-1994-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) - Komuna e Suharekës.

2. Mbetet në fuqi B58 “Njoftimi mbi Vendimin i Autoritetit Kontraktues”, anktiviteti i prokurimit sipas dispozitivit I të këtij vendimi.

3. Lejohet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar ashtu që obligohet operatori ekonomik ankues që brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve pas pranimit të këtij vendimi të parashtroj kërkesë për kthimin e tarifës në përputhje me nenin 31 par. 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, nën paralajmërimin që nëse nuk parashtrohet kërkesa brenda afatit, do të bëhet konfiskimi i depozitës dhe të gjitha mjetet e deponuara do të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me datë 04.04.2025 Komuna e Suharekës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rikonstruimi i kulmit të SH.M. Gjinnazi jeta e Re - Suhareke” me numër të prokurimit 624-25-1994-5-2-1. Autoriteti Kontraktues gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës për punë, me vlerë të parashikuar është 180,000.00€.

Me datë 12.06.2025, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 ku për këtë aktivitetit të prokurimit ka shpërblyer me kontratë GOE “Agim Trolli B.I. & NBT - ING ShPK”.

Me datë 17.06.2025, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin B58, të cilën AK e ka refuzuar si të pabazuar me datë 20.06.2025.

Me datë 30.06.2025 operatori ekonomik ankues ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2025/0568.

- Mbi fazën e shqyrtimit paraprak -

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë OSHP ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë si vijon:

Pretendimi 1 – “DUD doganor nuk është i qartë: OE ankues sqaron se është njoftuar përmes formularit B58 nga Autoriteti Kontraktues – Komuna Suharekë, për eliminim nga procedura për shkak se DUD doganor nuk është vërejtur qartë, OE përmes këtij pretendimi ankimor konsideron se vlerësimi i bërë nga AK është subjektiv dhe jo objektiv, gjë që është në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik (LPP) dhe Rregulloren për Udhëzimin dhe Procedurat e Operimit të Prokurimit Publik (RRUOPP), konkretisht shkeje e neni 39.8 të RRUOPP dhe shkelje edhe të LPP-së Neni 72 që trajton dokumentacionin dhe informacionin shtesë. OE ankues thekson se AK përmes përgjegje në këtë procedurë prokurimi na e hedh poshtë interpretimin tone në lidhje me nenin 39.8 dhe na kundërpërgjigjet me një nen KOMPLET TJETËR. OE duke u referuar nenit 39.8 të RRUOPP dhe nenit 72 të LPP-se thekson se ne rast se DUD doganor sipas Autoritetit Kontraktues nuk është vërejtur qartë, atëherë detyrë e tyre ishte të kërkohej sqarim nga ne si OE”.

Pretendimi 2-“Rimorkio e rënde per bartjen e Pretendimi ankimor rreth kerkesave shtesë në dosje të tenderit rreth pasijeve saktësisht nje Rimorkio e rende per Bartjen e Makinerise. OE ankues sqaron permes këtij pretendimi se ka ofruar marrëveshje bashkëpunimi me kompaninë Gashi ING SHPK, për project sipas kerkeses se AK ndersa AK e eliminon duke iu referuar ctoj : “AK në DT në kërkesën 11 ka kërkuar rimorkio për bartjen e makineris, andaj ju keni ofruar marrëveshje për shfrytëzimin e makinerise dhe keni prezantuar 3 copë rimorkio por pa validitet qarkullimi”. OE vazhdon tuje duke pretenduar se në fazën e hapjes dhe vlerësimit të ofertave, rimorkio nuk është në qarkullim për këtë procedurë- s’ka pse të jetë në qarkullim se nuk nevojitet në këtë faze Nëse është dashur gjithsesi të dëshmohet validiteti i regjistrimit në këtë fazë të kësaj procedure, është mundur të kërkonte sqarim shtesë sipas OE ankues”.

Pretendimi 3 – “Një ngarkues (Ult) pesha (min 5000 Pretendimi ankimor i OE ankues në lidhje me pasijen -Një ngarkues (ULT) me peshë minimale 5000 KG.Operatori ekonomik sqaron se ka prezantuar marrëveshjen me kompaninë Qamili NTSH (Naser Duraku B.I.) konform kërkesës së specifikuar në DT. Sipas OE, Autoriteti Kontraktues (AK) ka shkuar përtej kërkesave të DT-së duke e konsideruar të pavlefshme marrëveshjen me kompaninë në fjalë lidhur me pajisjen,

përkundër faktit se OE ka prezantuar DUD-in sipas DT-së dhe marrëveshjen ligjore sipas DT. Në vazhdim, OE ankues shkëput pjesën e përgjigjes së AK-së dhënë përmes formularit B-58, lidhur me pajisjen ULT: Marrëveshja e OE-së me NTSH Qamili është prezantuar. DUDI i ngarkuesit marka WL470 6500 KG është në emër të personit Afrim Xhafiqi, i cili nuk korrespondon me marrëveshjen në fjalë ndërmjet BAJRAM HA GASHI B.I. dhe NTSH QAMILF”.

Pretendimi 4 – “Kompresorët e Pretendimi ankimore i OE ankues se kemi plotësuar kërkesën specifike dhe dalluese të përcaktuar në DT lidhur me të pajisjet e kërkuara. Përkatësisht Kërkesa 11 dhe dëshmia 11, lidhur me kompresorët e ajrit ku OE ka bashkangjitur dëshmi Marrëveshjet përkatëse me bashkëpunëtorë lidhur me përdorimin e këtyre pajisjeve për këtë projekt, përkatësisht Marrëveshje me Alpe SHPK, Erst BAU SHPK, Bageri SHPK dhe marrëveshjet përkatëse në këtë procedurë të prokurimit publik, lidhur me kompresorin e ajrit sipas kriterit të përcaktuar kërkesa në lidhje me kompresorin e ajrit ishte :Kompresor ajri 10 bar (min.7.5KW) dhe kompresor ajri 10 bar 15KV”.

Pretendimi 5 – “Qasja e kufizuar në : OE ankues pretendon se i është dhënë qasje e kufizuar vetëm në disa dokumente të OE-së së rekomanduar për kontratë, konkretisht: deklaratën nën betim për sekretin afarist marrëveshjen e konsorciumit, sigurimin e tenderit, dokumentacionin e biznesit, ISO-n dhe OE thekson se qasja e kufizuar në dokumentacionit e kërkur nga 12.06.2026 është dhënë më 16.06.2025 pas perseritjes se kërkeses, qasja është mohuar me arsyetimin e mbrojtjes së sekretit afarist. Ky mohimi i qasjes ka përfshirë dokumentacionin që lidhet me: Gjendjen ekonomike dhe financiare (pika 8.1 & 8.2 e DT-së – kapaciteti ekonomik dhe financiar dhe dëshmitë përkatëse); Mundësitë teknike dhe/ose profesionale (pika 9.1 & 9.2 e DT-së – kapaciteti teknik dhe profesional dhe dëshmitë përkatëse 1-12). OE pretendon se Autoriteti Kontraktues nuk ka ofruar version të pastruar të dokumentacionit dhe konsideron se mohimi i qasjes në dokumentacion publik përbën shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042 (LPP), të ndryshuar dhe plotësuar, si dhe të Rregullores për Prokurim Publik nr. 001/2022 dhe Nenit 97, pika C), të Rregullores për Prokurim Publik nr. 001/2022”.

Pretendimi 6 – “GOE të rekomanduar për kontratë nuk e plotëson këtë kërkesë të DT. Te kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional, në kuadër të pikës 9.1 & 9.2, Kërkesa 2 - Një (1) Inxhinier i diplomuar ndërtimtarisë ose master i diplomuar (menaxher i projektit) – drejtimi konstruktiv me me se paku pese (5) vite pervoje pune pas diplomimit. Te jeti I certifikuar mbrojtja dhe siguri ne pune, I certifikuar mbrojtja nga zjarri dhe nderhyrja ndaj emergjencave, I certifikuar per eficence te energjise, I certifikuar sipas standartit 9001 2015 Lead Auditor dhe sipas standartit 45001 2018 Lead Auditor. Dëshmia 2 - CVa e nenshkruar nga vete personi, kopja e Diplomes si dhe referencat mbi pervojen e punes, Kontrata e punes me punedhenesin ose parakontrate mbi angazhimin per kete projekt, si dhe kopja e certifikatave te kerkuar. GOE të rekomanduar për kontratë nuk e plotëson këtë kërkesë të DT. Edhe pse AK siç e kemi paraqitur në pretendimin nr 5, na ka mohuar qasjen plotësisht, përvoja jonë e gjatë në aktivitete të shumta të prokurimit publik na ka mundësuar që të njohim tregun rrjedhimisht edhe konkurrencën dhe kapacitetet e tyre, andaj duke e ditur kapacitetin e tyre nga e kaluara, dyshojmë se i mungon përvoja e menaxherit, mungon dëshmia se është i certifikuar për SSHP dhe po ashtu dyshojmë se nuk posedon fare certifikatë për mbrojtje nga zjarri apo certifikatën për mbrojtje nga zjarri e ka me afat të skaduar, dyshojmë edhe në certifikimet tjera dhe përvojën e punës e dokumentacionin tjetër, andaj kërkojmë që kjo çështje të rishqyrtohet më në detaje nga AK”.

Pretendimi 7 – “Mosplotësimi i kërkesave të DT nga OE i rekomanduar -Kërkesa /Deshmia OE ankues pretendon se GOE i rekomanduar për kontratë nuk i plotëson kriter duke theksuar se dyshojmë se GOE të rekomanduar për kontratë nuk e plotëson këtë kërkesë të DT, pikërisht duke e ditur kapacitetin e tyre nga e kaluara pretendojmë se i mungon përvoja e inxhinierit të hidroteknikës, pretendojmë se inxhinieri në fjalë nuk e ka të dëshmuar përvojën siç është kërkuar, dyshojmë se i mungojnë referencat e punës dhe certifikatat, si rrjedhojë në ofertë nuk janë prezantuar dëshmi sipas kërkesës së AK-së”.

Pretendimi 8 – “Mosplotësimi i kërkesave të DT nga OE i rekomanduar -Kërkesa /Deshmia OE ankues pretendon se për shkak të kufizimit të qasjes në dokumentacion, duke e ditur kapacitetin e tyre nga e kaluara ne kemi arsye të dyshojmë se GOE të rekomanduar për kontratë nuk e plotëson këtë kërkesë të DT, pikërisht pretendojmë se i mungon përvoja e inxhinierit të elektros, dyshojmë se i mungojnë referencat e punës, si rrjedhojë në ofertë janë të papërgjegjshëm edhe në këtë pikë”.

Pretendimi 9- “Mosplotësimi i kërkesave të DT nga OE i rekomanduar - Kërkesa /Deshmia Pretendimi i radhes nga OE ankues se për shkak të kufizimit të qasjes në dokumentacion, duke e ditur kapacitetin e tyre nga e kaluara ne kemi arsye të dyshojmë se GOE të rekomanduar për kontratë nuk e plotëson këtë kërkesë të DT, pikërisht pretendojmë se i mungon përvoja e stafit të kërkuar- teknik i ndërtimtarisë sipas specifikave në kërkesën 5 përkatësisht dëshminë 5, referencat e punës mungojnë, mungon apo është jovalid kontrata me GOE për projekt apo kontratë pune me GOE në fjalë”.

Pretendimi 10-“Mosplotësimi i kërkesave të DT nga OE i rekomanduar - Kërkesa /Deshmia Edhe në këtë pretendim OE ankues ka dyshime në mosplotësim të kriterëve nga GOE i rekomanduar për kontratë lidhur me përvojën e inxhinierit të makinerisë dhe referencat mbi përvojën e punës”.

Pretendimi 11- “Mosplotësimi i kërkesave të DT nga OE i rekomanduar - Kërkesa /Deshmia Lidhur me këtë kërkesë nga DT ne dyshojmë se GOE i rekomanduar për kontratë ka mangësi të theksuara në dokumentacionin e ofruar ose dokumentacioni i ofruar lidhur me këtë kërkesë Master ose bachelor i diplomuar i emergjencave, si dhe vitet e cekura të përvojës së punës mungojnë e po ashtu dyshojmë se i mungon dokumentacion valid i referencave dhe kontratës së punës apo parakontratës për angazhim në projekt. Ose ka çështje të natyrës administrative për të cilat AK Komuna Suharekë ka aplikuar standarde të dyfishta duke e favorizuar GOE e rekomanduar për kontratë dhe duke mos respektuar parimet e përcaktuara nga LPP”.

Pretendimi 12-“Mosplotësimi i kërkesave të DT nga OE i rekomanduar -Kërkesa /Deshmia . Pretendimi ankues i OE ankues ku thekson se duke u bazuar mbi përvojën tonë me GOE në fjalë, duke e ditur kapacitetin e tyre nga e kaluara ne kemi arsye të dyshojmë se GOE të rekomanduar për kontratë nuk i plotëson këto kërkesa të DT, pikërisht pretendojmë se ju mungojnë kualifikimet e duhura për stafin e cekur në kërkesat 9, 10 dhe 12 dëshmitë përkatëse. Dëshmia mbi kualifikimin nëse është prezantuar dyshojmë se është nga kompani e licensuar për ofrimin e shërbimeve apo certifikimeve të tilla, dmth dokumentacioni përgjithsisht lidhur me kualifikimet e stafit sipas këtyre pikave dyshojmë se është valid”.

Pretendimi 13- “Mosplotësimi i kërkesave të DT nga OE i rekomanduar -Kërkesa /Deshmia 11- . Siç u tha më sipër, ne bazohemi mbi përvojën tonë me GOE në fjalë, duke e ditur kapacitetin e

tyre nga e kaluara ne kemi arsye të dyshojmë se GOE të rekomanduar për kontratë nuk i plotëson këto kërkesa të DT, pikërisht pretendojmë se ju mungojnë specifikimet teknike sipas kërkesës 11 të DT përkatësisht dëshmia 11, ngritësi (lifti) i kërkuar platformë me rrymë nuk është i tillë, ju mungon edhe specifikimet e pajisjeve kompresor ajri, ju mungon rimorkio me specifikimet e paraqitura në DT”.

Pretendimi 14- “Në rastin konkret, përveç pretendimeve të ngritura nga OE ankues, është ky pretendim rreth kompanive tjera që kanë marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi publik kanë ofruar çmime më të larta se sa oferta e OE ankues. Për më tepër, këto kompani janë shpallur të papërgjegjshme sipas vendimit të Autoritetit Kontraktues (AK), në këtë rast OE AAB Construction SHPK”.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave -

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 09.07.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës ndërsa me datë 19.07.2025 është dorëzuar raporti i ekspertizës nga eksperti shqyrtues me rekomandimet si në vijim: “Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon qëllënda të kthehet në rivlerësim”.

Konstatimet e ekspertit shqyrtues

Pretendimi nr. 1 – “Eksperti shqyrtues sqaron Neni 39.8 I RRUOPP ka të beje me Rregullore dhe udhëzues operativ për prokurim publik (RRUOPP) e cila është e shfuqizuar dhe tani interpretimi i nenit 39.8 ku AK-Suharekë I është referuar ka të bej me Rregullore Nr.002/2024 për Plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik e cila është e publikuar nga data 11.11.2024 dhe aktualisht është në fuqi. Rregullorja në fuqi neni 38 - Sqarimi I tendereve- në të cilën OE ankues I është konkretisht ka të bej me nenin 38.5

Autoriteti Kontraktues mund të ftojë Operatorët Ekonomik për të plotësuar apo të qartësojnë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të LPP-se d.m.th dëshmitë e dorëzuara për kërkesat e përshtatshmërisë, kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, gjendjes ekonomike dhe financiare dhe aftësisë teknike dhe profesionale, certifikatat e kualitetit, kërkesat e grupeve të OE. Sipas Neni 72- Dokumentacioni dhe informacioni shtesë citoj paragrafi 1,2 dhe 3 Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji. Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive. Bazuar në të të dhënat e lartëcekura dhe në dokumentacionin e dorëzuar nga ana e

OE ankues DUD doganor nuk është i qartë dhe Autoriteti kontraktues bazuar në nenin 72 I LPP-së dhe nenin 38.5 I rregullores në fuqi ka mundur të kërkojë sqarim. Eksperti shqyrtues sqaron se

kërkesë për sqarime është në të drejtën e Autoritetit kontraktues. Pretendimi ankimor është pa ”.

Pretendimi

2

—

“Eksperti shqyrtues sqaron se në DT kërkesa/Dëshmia nga ana e AK ishte Kërkesa 11 - Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit. Lista Makinerise, të kete keto paisje: Nje Rimorkio e rende per Bartjen e Makinerise. Dëshmia 11 - OE duhet të ofroj një listë të pajisjeve, Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen. Ne rastet kur OE ka mareveshje për shfrytëzimin, OE duhet të dorëzojë edhe marreveshjen për shfrytëzim paisjeve. Eksperti shqyrtues vërteton se Operatori Ekonomik ankues përmes Marreveshjes nuk ka ofruar librezën e vlefshme qarkullimi për Rimorkio të rëndë për bartjen e makinerisë, në momentin e aplikimit. Edhe pse në dosjen e tenderit nuk është specifikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë se librezat e qarkullimit duhet të jenë “me validitet”, vetë kërkesa për të dorëzuar librezën e qarkullimit nga ana e AK-së, qëllimi ka qenë i qartë – sigurimi i mjeteve të regjistruara dhe të gatshme për përdorim, në përputhje me ligjet që rregullojnë qarkullimin rrugor dhe regjistrimin e mjeteve sepse kërkesa për librezat të qarkullimit të mjeteve që janë të paregjistruara apo me afat regjistrimi të skaduar, do të ishte kërkesë për dokumentin të pavlefshëm në aspektin funksional dhe ligjor. Si rrjedhojë, dhe mungesa e dëshmive rreth vlefshmërisë së regjistrimit me dorëzimin e ofertës edhe pse OE-ankues përmes kërkesës për rishqyrtim ka bashkëngjitur një librezë me afat regjistrimi deri më 22.04.2026 në momentin e aplikimit nuk është perbushur kërkesa e Pretendimi ankimor është ”.

Pretendimi 3 – *“Pas shqyrtimit të dokumentacionit të ofertës dhe pretendimeve të parashtruara në ankesë, eksperti shqyrtues ka verifikuar Marreveshjen e ofruar nga operatori ekonomik ankues si dhe kontratën noteriale të shitblerjes të lidhur ndërmjet N.T.SH. "Qamili" dhe z. Afrim Xhafiqi.*

Në

përmbajtjen e kësaj kontrate theksohet qartë edhe numri referues i Dokumentit Unik Doganor (DUD), i cili përputhet plotësisht me numrin e referencës së dokumentit të paraqitur në ofertë. Ky fakt dëshmon se operatori ekonomik ankues ka paraqitur dëshmi të vlefshme dhe të harmonizuara për të vërtetuar përmbushjen e kriterit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktues. Dokumentet janë në përputhje të plotë me njëra-tjetrën dhe formojnë një bazë të besueshme për vërtetimin e pronësisë apo posedimit të mjeteve të ofruara në ofertë. Pretendimi ankimor është i ”.

Pretendimi 4– *“Eksperti shqyrtues pas verifikimit të dokumentacionit në lidhje me kompresorin e ajrit OE plotëson kërkesën min.15KW duke prezantuar kompresor ajri prej 22KW por nuk e plotëson kërkesën BAR sepse i njëjti kompresor në DUD të ofruar dhe faturën e shitblerjes përmban të dhëna prej 3 BAR dhe jo 10BAR siç ishte kërkesa e AK-së .Kompresor ajri i ofruar e përmbushin kërkesën e AK-së me 10 BAR po jo edhe KW I cila 14.5 KW. Disa prej tyre nuk përmbajnë të dhëna specifike, të gjitha pajisjet e ofruara kompresor ajri eksperti shqyrtues sqaron se AK ka mundur të kërkojë sqarim për të kuptuar se pajisjet e ofruar mund të përmbushin këto kritere dhe janë teknikisht të përshtatshme për përdorimin mundshëm të synuar, sipas kërkesës së AK-së pasi që OE ankues ka qenë me çmim më të ulët”.*

Pretendimi 5 – *“Eksperti shqyrtues sqaron OE I rekomanduar ka plotësuar kërkesën për secret afarise dhe Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, në mosdhënien e qasjes në dokumentacionin e kërkuar, nuk është bazuar në Nenin 11, pika 4 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe Neni 7 Informata Sekrete afariste dhe Qasja në Dokumentacion, Rregullorja 001/2022 për Prokurimin Publik, duke e cenuar kështu një të drejtë të garantuar me*

ligj. Në këtë rast ZPP nuk ka vepruar në harmoni me Neni 7.6.2 Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit menjëherë pas procesit të hapjes së ofertave dhe para publikimit të B58 “Njoftimi mbi vendimin e AK-së”, duhet të përgatitë versionin e pastruar në përputhje me paragrafin 4 të nenit 11 të LPP-së dhe të njoftojë palën. Shih: RRPP (Versioni i Konsoliduar) Neni 7.6.3 Zyrtari i Prokurimit sipas kërkesës për qasje në dokumente nga OE (siç përkufizohet në nenin 4, paragrafi 1, nën paragrafi 1.26 të LPP-së), pas publikimit të Njoftimit mbi vendimin e AK (B58), ofron qasjen e menjëhershme në versionin e pastruar dhe mban procesverbal, i cili nënshkruhet nga të dyja palët. Neni 7.6.5 Jo të gjitha dokumentet e specifikuar nga Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë në përputhje me nenin 68 dhe 69 të LPP-së, mund të klasifikohen si informata sekrete afariste. Dokumentet e specifikuar sipas nenit 68 e 69 të LPP e të cilat janë publike në bazë të këtij ligji dhe legjislacionit tjetër përkatës në fuqi, nuk mund të klasifikohen si informata sekrete afariste. Eksperti shqyrtues sqaron se është përgjegjësi e Autoritetit Kontraktues (AK) që të sigurojë që pjesët e deklaruara si sekret afarist (jo të gjitha dokumentet në nenin 68, 69 të LPP-së), nuk vihen në dispozicion të Operatorëve Ekonomikë të tjerë. Ky proces duhet të realizohet duke respektuar dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe ligjet e tjera në Për më tepër, AK - ZPP është i detyruar të përgatisë versionin e spastruar të dokumenteve në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik dhe Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (Versioni i Konsoliduar), duke siguruar mbrojtjen e informacionit konfidencial dhe respektimin e të drejtave të të gjithë palëve të përfshira në një aktivitet të prokurimit - lejimi dhe mos neglizhimi i qasjes në dokumente zyrtare sipas kërkesës me shkrim të parashtruar nga pala e interesit kur një qasje e tillë e kërkuar është në përputhje me nenin 10 dhe 11 të Ligjit të Prokurimit Publik. Pretendimi ankimor duke u bazuar në dëshmitë e lartë cekura është i

Pretendimi 6 – “Eksperti shqyrtues për shkak të mbrojtjes së të dhënave konfidenciale sqaron se pretendimi ankimor në lidhje me dyshimet e mos plotësimi të Kërkesë/Deshmia 2 pas verifikimit të dokumentacionit të plotë për personin e emëruar si menaxher i projektit, nga ana e OE I rekomanduar për kontratë, u konstatua se janë dorëzuar dokumente si me poshtë: CV-ja e personit të emëruar si menaxher i projektit është dorëzuar dhe është nënshkruar nga vetë personi, përmban të dhëna të mjaftueshme mbi përvojën dhe kualifikimet profesionale. Referencat për përvojën e punës janë ofruar dhe mbështesin përvojën mbi 5 vite pas Janë bashkangjitur kopjet e certifikatave të kërkuara, të gjitha të vlefshme me dorëzim të ofertave. Certifikatat mbulojnë të gjitha fushat e kërkuara dhe të gjitha janë në harmoni me kërkesën/deshmitë nr.2. Rrjedhimisht dyshimet në lidhje me këtë pretendim nuk ”.

Pretendimi 7 – “Eksperti shqyrtues rreth pretendimit ankimor në lidhje me dyshimet e mos plotësimi të Kërkesë/Deshmia 4 pas verifikimit të dokumentacionit të plotë për personin e emëruar si inxhinier të hidroteknikës, nga ana e OE I rekomanduar për kontratë, u konstatua se janë dorëzuar dokumente si me CV-ja e inxhinierit është dorëzuar dhe është nënshkruar nga vetë Referencat për përvojën e punës janë ofruar dhe mbështesin përvojën mbi 5 vite pas Nuk është kërkuar certifikata për kërkesën/deshmitë nr.3. Rrjedhimisht dyshimet në lidhje me këtë pretendim nuk qëndron”.

Pretendimi 8 – “Eksperti shqyrtues rreth pretendimit ankimor në lidhje me dyshimet e mos plotësimi të Kërkesë/Deshmia 4 pas verifikimit të dokumentacionit të plotë për personin e emëruar si inxhinier të elektros, nga ana e OE I rekomanduar për kontratë, u konstatua se janë dorëzuar dokumente si me poshtë: CV-ja e inxhinierit është dorëzuar dhe është nënshkruar nga vetë Referencat për përvojën e punës

janë ofruar dhe mbështesin përvojën mbi 5 vite pas
Rrjedhimisht dyshimet në lidhje me këtë pretendim nuk ”.

Pretendimi

9

“Eksperti shqyrtues rreth pretendimit ankimor në lidhje me dyshimet e mos plotesimit Kërkesë 5 pas verifikimit të dokumentacion të plotë stafit të kërkuar- Teknik I ndertimtrise ,nga ana e OE I rekomanduar për kontrate, u konstatua se janë dorëzuar dokumente si me poshtë: CV-ja e inxhinierit është dorëzuar dhe është e nënshkruar nga vetë Referencat për përvojën e punës janë ofruar dhe mbështesin përvojën mbi 5 vite pas Kontratë të Rrjedhimisht dyshimet në lidhje me këtë pretendim nuk ”.

Pretendimi 10 – “Eksperti shqyrtues rreth pretendimit ankimor në lidhje me dyshimet e mos plotesimit të Kërkesë/ Deshmia 6 pas verifikimit të dokumentacion të e inxhinierit të makinerisë , u konstatua se janë dorëzuar dokumente si me poshtë:CV-ja e inxhinierit është dorëzuar dhe është e nënshkruar nga vetë Referencat për përvojën e punës janë ofruar dhe mbështesin përvojën mbi 5 vite pas Kontratë e Rrjedhimisht dyshimet në lidhje me këtë pretendim nuk ”.

Pretendimi 11 – “Eksperti shqyrtues rreth pretendimit ankimor në lidhje me dyshimet e mos plotesimit të Kërkesë/Deshmia 6 pas verifikimit të dokumentacion të e inxhinierit Master ose bachelor i diplomuar i emergjencave,, u konstatua se janë dorëzuar dokumente si me poshtë:CV-ja e inxhinierit është dorëzuar dhe është e nënshkruar nga vetë Referencat për përvojën e punës janë ofruar dhe mbështesin përvojën vite pas diplomimit. Rrjedhimisht dyshimet në lidhje me këtë pretendim nuk qëndron”.

Pretendimi 12 – “Eksperti shqyrtues rreth pretendimit ankimor në lidhje me dyshimet e mos plotesimit të Kërkesë/Deshmia 9,10,12 pas verifikimit të dokumentacion konstaton se OE i rekomanduar ploteson kërkesën 9 dhe 12 po jo kërkesën 10. (mungojnë kontratat dhe parakontratat). Rrjedhimisht dyshimet në lidhje me këtë pretendim nuk qëndron”.

Pretendimi 13 – “Eksperti shqyrtues në lidhje me këtë pretendim thekson se OE I rekomanduar ka dorëzuar vetëm libreze qarkullim ,rimoriko e rende mungon DUD ndersa tek kompresori I ajrit 10 BAR në DUD nuk e plotson kërkesë e AK-se pasi që nuk ka specifika fare për KW. Pretendimi ankimor është pjesërisht i

Pretendimi 14 – “Eksperti shqyrtues sqaron se nga analiza e dosjes dhe dokumentacionit të prokurimit rezulton se kompanitë e tjera pjesëmarrëse në këtë procedurë kanë ofruar çmime më të larta dhe, sipas vendimit të Autoritetit Kontraktues (AK) – në këtë rast OE AAB Construction SHPK, janë shpallur të papërgjegjshme”.

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtrësat e palëve dhe veprimet e tyre, përbëjnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të provave sipas ankesës së dorëzuar sqaron se konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues për këtë lëndë janë pjesërisht të qëndrueshme. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin vetëm pjesërisht konstatimeve të ekspertit shqyrtues.

Vlen të theksohet fakti se për Panelin Shqyrtues, konstatimet dhe rekomandimet e ekspertëve shqyrtues nuk janë të detyrueshme, por shërbejnë vetëm si një provë në mesin e të gjitha provave tjera që vlerëson në secilën lëndë veç e veç. Paneli Shqyrtues vendos në mënyrë të pavarur, objektive dhe me kujdesin e duhur profesional duke mbrojtur gjithmonë interesin e publikut përmes LPP dhe legjislacionit sekondar në fuqi për prokurimin publik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave ka vepruar në përputhje me LPP në fuqi.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrësit dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues dhe operatorit ekonomik fitues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet tjera relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Paneli Shqyrtues pajtohet me konstatimet e ekspertës shqyrtuese lidhur me pretendimet ankimore me numër 1, 2, 4, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12 dhe 14 sipas të cilave këto njëmbëdhjeta pretendimet janë të pabazuara.

Paneli Shqyrtues pajtohet pjesërisht me konstatimet lidhur me pretendimet 3 dhe 5 ku konstatohet se këto pretendime janë të bazuara për çka lidhur me pretendimin ankimor nr 5 PSH i shqipton vërejtje ZPP-së, ngase edhe LPP-ja nen 10 dhe 11 i LPP-së qartësisht përshkruan se si AK-të duhet veprojnë në raste se kur kërkohet qasja si në rastin konkret nga OE ankues, si dhe pretendimet 12 dhe 13 ku konstatohet se këto pretendime janë pjesërisht të bazuara. Megjithatë për shkak të pretendimeve të tjera ankimore të cilat janë gjetur si të pabazuara, është konfirmuar se OE ankues ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për shkak se nuk ka përmbushur kërkesat e DT konkretisht në pretendimin 4 lidhur me kompresorin e ajrit OE plotëson kërkesën min.15KW, dhe kërkesën lidhur me kompresor rezerve 7.5 kw ku AK ja nuk ka aplikuar nenin 59.4 të LPP-se, aplikimi i till i cili bijen në distreksionin e AK-se citoj “ 4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve”. Po ashtu OE ankues as në Kërkesë për Rishqyrtim pran AK-së e as edhe në ankesën e deponuar pranë OSHP-se nuk ka arritur të ofron prova-fakte se këto dy kërkesa të parashtruara tek kërkesat mbi mundësin teknike/profesionale në NJK dhe DT, mirëpo sipas kërkesës për rishqyrtim ka cituar “ se janë teknikisht përshtatshme për

përdorim të mundshëm të siguruar'', andaj për këtë arsye Paneli shqyrtues nuk pajtohet me rekomandimet e ekspertës shqyrtuese ku thuhet se aktiviteti i prokurimit duhet të kthehet në rivlerësim. Në rastin konkret Paneli Shqyrtues ka vlerësuar dokumentet në mënyrën e elaboruar si më sipër, dhe ka gjetur nuk ekziston bazë e mjaftueshme për të kthyer në rivlerësim aktivitetin e prokurimit pasi që rivlerësimi nuk do të mund të merrte ndonjë epilog thellësisht më ndryshe sesa vendimi aktual i AK-së.

Paneli Shqyrtues mbështetur në nenin 1 dhe 7, ku ka marrë parasysh edhe nenin 104 par. 4 të LPP ku përcaktohet se *“Në ndërmarrjen e masave të përcaktuara OSHP duhet të veprojë në mënyrë proporcionale me shkëlqen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik”*. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues është nisur nga parimi themelor për mbrojtjen e interesit të publikut qoftë në aspektin e parandalimit të vonësive të paarsyeshme.

Poashtu AK-ja duhet të merë parasyshë nenin 9 të LPP-së, si dhe nenin 24 par 1 dhe 2 , dhe neni 59 par 1. *Autoriteti kontraktues do të themeloj një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës ”*.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkesat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të aprovohet si pjesërisht e bazuar ndërsa mbetet në fuqi B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Komuna e Suharekës , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rikonstruimi i kulmitte SH.M. Gjumnazi jeta e Re - Suhareke” me numër të prokurimit 624-25-1994-5-2-1, pasi që nuk ekzistojnë argumente të mjaftueshme ligjore për të urdhëruar AK që të kthej aktivitetin e prokurimit në rivlerësim, për arsyet si më sipër në këtë vendim.

Paneli Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veprojë në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi. Në të kundërtën OSHP mund të inicoj procedurat disiplinore ndaj zyrtarëve të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA SUHAREKË**
- **OE - BAJRAM HA.GASHI B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: